RELACION SHPJEGUES

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR KËRKESAT E SIGURISË KIBERNETIKE PËR PRODUKTET ME ELEMENTË DIGJITALË DHE QËNDRUESHMËRINË KIBERNETIKE"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Qëllimi i projektligjit "Për kërkesat e sigurisë kibernetike për produktet me elementë digjitalë dhe qëndrueshmërinë kibernetike" është vendosja e një kuadri ligjor të unifikuar për garantimin e sigurisë kibernetike të produkteve me elementë digjitalë që vendosen dhe bëhen të disponueshme në tregun shqiptar, duke përcaktuar kërkesat thelbësore të sigurisë kibernetike për projektimin, zhvillimin dhe prodhimin e tyre, si dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë dhe rregullat për trajtimin e vulnerabiliteteve gjatë periudhës së mbështetjes.

Projektligji përcakton gjithashtu rregulla për vlerësimin e konformitetit, vendosjen e markimit CE, njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit, mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e masave korrigjuese në rastet e moskonformitetit. Në këtë mënyrë, synohet që siguria kibernetike të trajtohet si pjesë e ciklit të plotë jetësor të produkteve me elementë digjitalë.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- krijimi i një kuadri ligjor të qartë dhe të unifikuar për sigurinë kibernetike të produkteve me elementë digjitalë dhe për qëndrueshmërinë e tyre gjatë ciklit jetësor;
- vendosja e kërkesave thelbësore të sigurisë kibernetike për projektimin, zhvillimin dhe prodhimin e produkteve me elementë digjitalë;
- përcaktimi i detyrimeve të prodhuesve, përfaqësuesve të autorizuar, importuesve dhe shpërndarësve, përfshirë detyrimet për trajtimin e vulnerabiliteteve dhe raportimin e incidenteve;
- vendosja e një qasjeje të bazuar në risk për klasifikimin e produkteve të rëndësishme dhe kritike me elementë digjitalë dhe për procedurat e vlerësimit të konformitetit;
- forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes së tregut dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, përfshirë bashkëpunimin me CSIRT-in Kombëtar dhe autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale;
- krijimi i kushteve për përfshirjen e kërkesave të sigurisë kibernetike në prokurimin dhe përdorimin e produkteve me elementë digjitalë nga autoritetet publike;
- mbështetja e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe startup-eve në përmbushjen e kërkesave të ligjit;
- përafrimi i kuadrit shqiptar me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian në fushën e qëndrueshmërisë kibernetike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe synon të krijojë bazën ligjore për zbatimin në nivel kombëtar të kërkesave horizontale të sigurisë kibernetike për produktet me elementë digjitalë.

Projektligji është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, për vitin 2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 30.12.2025 për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026.

Në këtë kuadër, projektligji synon të mbështesë procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e qëndrueshmërisë kibernetike, sa i përket kërkesave të sigurisë kibernetike për produktet me elementë digjitalë si dhe të krijojë kushtet për një treg më të sigurt dhe më të besueshëm për produktet me elementë digjitalë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë e projektligjit

Rritja e numrit të produkteve të lidhura me rrjete dhe sisteme informacioni e bën të nevojshme që siguria kibernetike të trajtohet që në fazën e projektimit dhe zhvillimit të produktit. Projektligji vendos këtë qasje duke kërkuar që produktet me elementë digjitalë të bëhen të disponueshme në treg vetëm kur përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë kibernetike dhe kur proceset e prodhuesit për trajtimin e vulnerabiliteteve janë në përputhje me kërkesat përkatëse.

Një nga përparësitë kryesore është përcaktimi i përgjegjësive përgjatë zinxhirit të furnizimit. Prodhuesit duhet të kryejnë vlerësim të risqeve të sigurisë kibernetike dhe ta marrin atë në konsideratë gjatë planifikimit, projektimit, zhvillimit, prodhimit, dorëzimit dhe mirëmbajtjes së produktit. Importuesit dhe shpërndarësit kanë gjithashtu detyrime për verifikimin e konformitetit dhe marrjen e masave korrigjuese kur identifikohen raste moskonformiteti.

Projektligji dallon produktet e rëndësishme dhe kritike me elementë digjitalë dhe parashikon kërkesa të ndryshme për vlerësimin e konformitetit, duke marrë në konsideratë funksionalitetin dhe nivelin e riskut të sigurisë kibernetike. Për produktet kritike parashikohet, sipas rastit, përdorimi i skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike ose një skeme evropiane të certifikimit të sigurisë kibernetike.

Një element tjetër i rëndësishëm është vendosja e mekanizmave të raportimit të vulnerabiliteteve, incidenteve me ndikim në sigurinë e produktit dhe incidenteve të shmangura, përfshirë një platformë të vetme raportimi dhe rolin e CSIRT-it Kombëtar në trajtimin e njoftimeve.

Projektligji përfshin gjithashtu dispozita për softuerin e lirë dhe me burim të hapur, duke përcaktuar detyrime të posaçme për mirëmbajtësit e tij dhe duke parashikuar programe vullnetare të vërtetimit të sigurisë.

Problematikat

Zbatimi i projektligjit kërkon ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, teknike dhe njerëzore duke sjellë nevojën për investime të reja, veçanërisht për strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, autoritetin notifikues, si dhe për strukturat që do të mbështesin vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe trajtimin e vulnerabiliteteve.

Për operatorët ekonomikë, veçanërisht për prodhuesit dhe importuesit, zbatimi i kërkesave të reja mund të kërkojë përshtatje të proceseve të projektimit, zhvillimit, dokumentimit, testimit dhe mirëmbajtjes, si dhe investime për vlerësimin e konformitetit dhe trajtimin e vulnerabiliteteve gjatë periudhës së mbështetjes.

Gjithashtu, zbatimi efektiv i kërkesave për produktet e rëndësishme dhe kritike kërkon disponueshmërinë e kapaciteteve të përshtatshme të vlerësimit të konformitetit dhe të certifikimit të sigurisë kibernetike. Projektligji parashikon periudha kalimtare dhe masa mbështetëse për të lehtësuar këtë proces.

Efektet e pritshme

Zbatimi i projektligjit pritet të rrisë nivelin e sigurisë kibernetike të produkteve të vendosura dhe të bëra të disponueshme në treg si dhe të ulë ekspozimin ndaj vulnerabiliteteve të njohura dhe incidenteve që mund të cenojnë konfidencialitetin, integritetin, autenticitetin ose disponueshmërinë e të dhënave dhe funksioneve të produkteve.

Përcaktimi i detyrimeve të qarta për operatorët ekonomikë, mekanizmave të vlerësimit të konformitetit dhe kompetencave të mbikëqyrjes së tregut pritet të rrisë transparencën dhe sigurinë juridike, si dhe të forcojë besimin e përdoruesve dhe të tregut në produktet me elementë digjitalë.

Në planin institucional, projektligji krijon një bazë për bashkëpunim më të strukturuar ndërmjet strukturave të mbikëqyrjes së tregut, CSIRT-it Kombëtar, autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, organeve të vlerësimit të konformitetit dhe strukturave të tjera kompetente.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me legjislacionin vendas në fuqi. Gjithashtu, ky projektligj nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji është hartuar duke marrë si referencë kryesore Rregulloren (BE) 2024/2847 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Mbi kërkesat horizontale të sigurisë kibernetike për produktet me elementë digjitalë”, të njohur si Cyber Resilience Act (CRA). Rregullorja përcakton rregulla për vendosjen dhe bërjen të disponueshme në treg të produkteve me elementë digjitalë, kërkesa thelbësore të sigurisë kibernetike për projektimin, zhvillimin dhe prodhimin e tyre, si dhe detyrime për proceset e trajtimit të vulnerabiliteteve.

Në përshtatjen e kuadrit të BE-së në rendin e brendshëm, projektligji pasqyron në tërësinë e tij parashikimet e Rregullores së BE-së 2024/2847, përfshirë kërkesat për produktet me elementë digjitalë, klasifikimin e produkteve të rëndësishme dhe kritike, detyrimet e operatorëve ekonomikë, procedurat e vlerësimit të konformitetit, markimin CE, mbikëqyrjen e tregut, raportimin e vulnerabiliteteve dhe dispozitat për softuerin e lirë dhe me burim të hapur.

Duke qenë se Rregullorja e BE-së zbatohet drejtpërdrejt në shtetet anëtare, projektligji shqiptar përshtat në nivel kombëtar kërkesat dhe mekanizmat institucionalë të nevojshëm për zbatimin e një kuadri të harmonizuar me këtë rregullore, duke marrë në konsideratë statusin e Republikës së Shqipërisë si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Referenca e plotë e aktit të Bashkimit Evropian është: Rregullorja (BE) 2024/2847 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2024, OJ L 2024/2847, 20.11.2024. fq. 28-81.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Referuar përmbajtjes së projektaktit, projektligji përbëhet nga 61 nene dhe 8 anekse, të organizuara në krerë si më poshtë:

- Kreu I – Dispozita të përgjithshme.
- Kreu II – Detyrimet e operatorëve ekonomikë dhe dispozitat në lidhje me softuer-in e lirë dhe me burim të hapur.
- Kreu III – Konformiteti i produktit me elementë digjitalë.
- Kreu IV – Njoftimi i organeve të vlerësimit të konformitetit.
- Kreu V – Mbikëqyrja e tregut dhe zbatimi.
- Kreu VI – Konfidencialiteti dhe penalitetet.
- Kreu VII – Dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Në mënyrë më të detajuar:

Në kreun I përcaktohen objekti dhe fusha e zbatimit të projektligjit, përkufizimet, parimi i lëvizjes së lirë, rregullat për prokurimin ose përdorimin e produkteve me elementë digjitalë, kërkesat bazë për produktet me elementë digjital dhe klasifikimi i produkteve të rëndësishme dhe kritike me elementë digjital.

Në nenet 1–5 përcaktohen objekti, fusha e zbatimit, përkufizimet, lëvizja e lirë dhe kërkesat për prokurimin ose përdorimin e produkteve me elementë digjitalë. Neni 6 përcakton kushtet që duhet të plotësohen për bërjen të disponueshme në treg të produkteve me elementë digjitalë.

Nenet 7 dhe 8 trajtojnë produktet e rëndësishme dhe kritike me elementë digjitalë, përfshirë kriteret e klasifikimit dhe kërkesat për certifikim ose vlerësim të konformitetit në varësi të nivelit të riskut.

Neni 9 përcakton konsultimin me palët e interesuara. Neni 10 përcakton rritjen e aftësive në një mjedis digjital kibernetik. Neni 11 përcakton sigurinë e përgjithshme të produktit. Neni 12 përcakton sistemet e AI me rrezik të lartë.

Në kreun II përcaktohen detyrimet e prodhuesve dhe operatorëve të tjerë ekonomikë. Prodhuesit duhet të kryejnë vlerësimin e riskut, të sigurojnë sigurinë e produktit gjatë ciklit të tij jetësor dhe të vendosin procedura për trajtimin e vulnerabiliteteve. Importuesit dhe shpërndarësit kanë detyrime për vlerësimin e konformitetit dhe marrjen e masave korrigjuese.

Në nenet 13-15, përcaktohen detyrimet e prodhuesve, detyrimet e prodhuesve për raportim si dhe raportimi vullnetar. Në nenin 16 dhe 17 përcaktohen krijimi i platformës së raportimit si dhe dispozitat lidhur me raportimin. Neni 18 përcakton përfaqësuesit e autorizuar. Në nenet 19 dhe 20 përcaktohen detyrimet e importuesve dhe detyrimet e shpërndarësve. Në nenet 21 dhe 22 përcaktohen rastet në të cilat detyrimet e prodhuesve zbatohen për importuesit dhe shpërndarësit si dhe Raste të tjera në të cilat zbatohen detyrimet e prodhuesve. Neni 23 përcakton identifikimin e operatorëve ekonomikë. Neni 24 përcakton detyrimet e mirëmbajtësve të softuerit me burim të hapur. Neni 25 përcakton vërtetimin e sigurisë së softuerit të lirë dhe me burim të hapur ndërsa neni 26 përmban përcaktime lidhur me udhëzimet.

Në kreun III përcaktohen kërkesat për standardet, specifikimet e përbashkëta, deklaratën e konformitetit, markimin CE, dokumentacionin teknik dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit. Për produktet e rëndësishme dhe kritike parashikohen procedura të ndryshme në varësi të klasifikimit dhe riskut. Në këtë kre përfshihen edhe masa mbështetëse për mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përfshirë startup-et, si dhe dispozita për marrëveshjet e njohjes reciproke.

Në nenet 27 dhe 28 përcaktohen prezumimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Në nenet 29 dhe 30 përcaktohen parimet e përgjithshme të markimit CE dhe rregullat dhe kushtet për vendosjen e markimit CE. Neni 31 përmban dispozita lidhur me dokumentacionin teknik. Neni 32 përcakton procedurat e vlerësimit të konformitetit për produktet me elementë digjitale. Neni 33 përcakton masat mbështetëse për mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke përfshirë startup-et. Neni 34 përmban dispozita lidhur me marrëveshjet e njohjes reciproke.

Kreu IV rregullon autoritetin notifikues, kërkesat për organet e vlerësimit të konformitetit, procedurën e aplikimit dhe njoftimit, detyrimet e organeve të notifikuara dhe koordinimin e tyre.

Nenet 35 dhe 36 përmbajnë dispozita lidhur me njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe autoritetin notifikues. Neni 37 përcakton kërkesat për autoritetet notifikuese, ndërsa neni 38 detyrimin e autoriteti notifikues për informimin e Komisionit Evropian. Neni 39 përcakton kërkesat për organet e notifikuara, ndërsa neni 40 prezumimin e konformitetit të organeve të notifikuara. Neni 41 përcakton dispozitat për degët dhe për nënkontraktimin nga organet e notifikuara.

Nenet 42 dhe 43 përmbajnë dispozitat lidhur me aplikimin për njoftim dhe procedurat e njoftimit të organeve të vlerësimit të konformitetit.

Neni 44 përcakto ndryshimet në njoftime. Neni 45 përcakton detyrimet operacionale të organeve të notifikuara, ndërsa neni 46 procedurën e ankesave kundër vendimeve të organeve të notifikuara.

Neni 47 përcakton detyrimet e informimit për organet e notifikuara, ndërsa neni 48 koordinimin e organeve të notifikuara.

Kreu V përcakton rregullat për mbikëqyrjen e tregut dhe kontrollin e produkteve me elementë digjitalë, aksesin në të dhëna dhe dokumentacion, procedurat kombëtare për produktet që paraqesin risk të konsiderueshëm, masat korrigjuese, ndalimin e tregtimit dhe kthimin e produkteve, si dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente.

Neni 49 përcakton mbikëqyrjen e tregut dhe kontrollin e produkteve me elementë digjitalë. Neni 50 rregullon aksesin në të dhëna dhe dokumentacion për vlerësimin e konformitetit të produkteve. Neni 51 përcakton procedurën në nivel kombëtar në lidhje me produktet me elementë digjitalë që paraqesin një risk të konsiderueshëm të sigurisë kibernetike. Neni 52 përcakton dispozita lidhur me produktet me elementë digjitalë në pajtueshmëri me kërkesat, të cilat paraqesin një risk të rëndësishëm për sigurinë kibernetike. Neni 53 përmban dispozita lidhur me mospërputhjen formale. Neni 54 përcakton aktivitetet e përbashkëta të strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, ndërsa neni 55 përcakton dispozita lidhur me veprimet e kontrollit.

Kreu VI përcakton dispozita lidhur me konfidencialitetin dhe penalitetet, duke përfshirë kundërvajtjet administrative dhe masat administrative të zbatueshme në rast shkeljeje të detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Neni 56 përcakton detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe të dhënave gjatë zbatimit të këtij ligji. Neni 57 përcakton kundërvajtjet dhe sanksionet administrative për shkeljen e kërkesave dhe detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret për përcaktimin e masës së gjobave.

Kreu VII përmban dispozitat kalimtare, vlerësimin dhe rishikimin e ligjit dhe hyrjen në fuqi.

Neni 58 përcakton aktet nënligjore që duhet të miratohen në zbatim të këtij ligji. Neni 59 përcakton dispozitat kalimtare. Neni 60 përcakton vlerësimin dhe rishikimin e ligjit. Neni 61 përcakton hyrjen në fuqi dhe zbatimin e ligjit.

ANEKSET

Anekset përmbajnë kërkesat thelbësore të sigurisë kibernetike, kategoritë e produkteve të rëndësishme dhe kritike, kategoritë e produkteve me elementë digjitalë, kërkesat për dokumentacionin teknik dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

Aneksi I përcakton kërkesat thelbësore të sigurisë kibernetike.

Aneksi II përcakton informacionin dhe udhëzimet për përdoruesin.

Aneksi III përcakton produktet e rëndësishme me elementë digjitalë.

Aneksi IV përcakton produktet kritike me elementë digjitalë.

Aneksi V përcakton deklaratën EU të konformitetit.

Aneksi VI përcakton deklaratën e thjeshtuar të konformitetit në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Aneksi VII përcakton përmbajtjen e dokumentacionit teknik.

Aneksi VIII përcakton procedurat e vlerësimit të konformitetit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të përcaktuara në projektakt:

- ministria përgjegjëse për komunikimet elektronike dhe digjitale;
- ministria përgjegjëse për ekonominë;
- autoriteti përgjegjës për sigurinë kibernetike;
- institucioni përgjegjës për inteligjencën artificiale sipas legjislacionit në fuqi;
- strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut;
- autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale;
- autoriteti përgjegjës për akreditimin;
- organet e notifikuara dhe operatorët ekonomikë që prodhojnë, importojnë, shpërndajnë ose bëjnë të disponueshme në treg produkte me elementë digjitalë;

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 55, datë 13 mars 2026, u ngrit një grup pune ndërinstitucional për hartimin e projektligjit "Për kërkesat e sigurisë kibernetike për produktet me elementë digjitalë dhe qëndrueshmërinë kibernetike". Grupi i punës u krijua me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me Rregulloren (BE) 2024/2847 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (Akti për Qëndrueshmërinë Kibernetike – CRA).

Projektligji është hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve të tjera pjesë e grupit të punës ndërinstitucional, të cilët kanë kontribuar në shqyrtimin dhe përafrimin e dispozitave të projektaktit me rregulloren Rregulloren (BE) 2024/2847.

Institucionet pjesëmarrëse në grupin ndërinstitucional të punës janë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit;
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;

- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve

Përfaqësuesit e këtyre institucioneve kanë kontribuar në procesin e hartimit dhe konsolidimit të projektligjit, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë dhe ekspertizës së tyre.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji pritet të sjellë efekte financiare për buxhetin e shtetit, të lidhura kryesisht me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike për mbikëqyrjen e tregut, përmes angazhimit të burimeve njerëzore të specializuara, sigurimit të mjeteve dhe sistemeve teknologjike, krijimit të kapaciteteve për mikëqyrje dhe kontroll, si dhe trajnimit të strukturave përgjegjëse.

Në këtë fazë, projektligji nuk përcakton një vlerë konkrete të kostos financiare. Përllogaritja e saktë e ndikimit buxhetor duhet të kryhet nga institucionet përgjegjëse gjatë procesit të vlerësimit financiar, mbi bazën e numrit të strukturave që do të ngarkohen, kapaciteteve ekzistuese, nevojave për personel, sistemeve teknike dhe masave të nevojshme për zbatimin e plotë të projektligjit.

Nga ana tjetër, zbatimi i kërkesave të sigurisë kibernetike pritet të sjellë përfitime ekonomike dhe institucionale në afat të mesëm dhe të gjatë, përmes reduktimit të riskut të incidenteve, përmirësimit të sigurisë së produkteve të vendosura në treg, rritjes së besimit në ekonominë digjitale dhe forcimit të kapacitetit kombëtar për menaxhimin e vulnerabiliteteve dhe incidenteve.